



e Rahovecit

1.5 milion euro investime të reja infrastrukturore në Rahovec

Komuna e Rahovecit, bashkë me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nënshkruan një memorandum bashkëpunimi që sjell mbi 1.5 milion euro.

Përmes këtij bashkëpunimi do të financohen dy projekte:

- Rregullimi i rrugës Sapniq - Nashpall, në vlerë prej 894,888.00 €;
- Ndërtimi i rrugës Fortesë - Celinë, në vlerë prej 650,000.00 €.



Nënshkruhen kontrata me 31 fermerë

Komuna e Rahovecit, së bashku me Qatar Charity, nënshkruan kontrata me 31 fermerë përfitues të serrave prej 1 ari, një projekt që sjell mundësi të reja dhe kushte më të mira për prodhim bujqësor në komunën e Rahovecit.

Komuna e Rahovecit ka financuar me 25%.



Shpërblehet denoncuesi i parë për ndotje të mjedisit

Komuna e Rahovecit ka shpërblyer një qytetar që raportoi ndotjen e mjedisit në komunën tonë. Ky gjest është një thirrje që të bashkohemi të gjithë në mbrojtjen e mjedisit.

Përmes ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit mund të ndërtohet një ambient më i pastër e më i gjelbër.



Ambasadori i Suedisë në Kosovë, Sh. T. Z. Jonas Westerlund, viziton Rahovecin

Kryetari i Komunës së Rahovecit, me bashkëpunëtorët, pritën në një takim miqësor ambasadorin e Suedisë në Kosovë, Sh. T. Z. Jonas Westerlund.

Në një bisedë të hapur dhe miqësore, ndanë ide dhe vizione për zhvillimin ekonomik lokal, ecurinë e projekteve që po realizohen dhe për trashëgiminë e pasur që e dallon Rahovecin si qytet i vreshtave, i traditës dhe mikpritës.



Kanë nisur punimet për ndërtimin e rrugës, kanalizimit dhe instalimeve të tjera nëntokësore në rrugën «Halil Hamza» në Rahovec, një investim i rëndësishëm për komunitetin.

